



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

DEKLARATË PËR SHTYP ¹

MBI NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË DHE ATË VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2004

09 KORRIK 2004

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1 Operacionet e tregut të hapur

Situata e likuiditetit në tremujorin e parë të vitit 2004 u karakterizua nga tepriçë likuiditeti, e shkaktuar nga rritja e depozitave të sistemit dhe rënia e nivelit të investimit në tregun primar. Për manaxhimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë, përveç ndërhyrjeve me instrumentin kryesor të tregut në vlerë mesatare prej 3.4 miliardë lekë, përdori dhe ankandin e marrëveshjes së riblerjes me maturim njemujor duke tërhequr 1.9 miliardë lekë gjatë pjesës së parë të tremujorit. Rritja e vazhdueshme e likuiditetit bëri të nevojshëm organizimin e shitjes me të drejta të plota të bonove të thesarit nga portofoli i Bankës së Shqipërisë. Vlera nominale e bonove të shitura ishte 4.5 miliardë lekë (ose 4.4 miliardë lekë e llogaritur me çmim blerjeje).

Tabela e mëposhtme paraqet vëllimin (në milionë lekë) e likuiditetit të tërhequr nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur.

Data	REPO javore	REPO Mujore	Shitje BTH me të drejta të plota
05-01-04	37		
08-01-04	617		
15-01-04	1,506		
22-01-04	2,943		
29-01-04	3,495		
05-02-04	3,310		
12-02-04	3,095	1,869	
19-02-04	2,347	1,869	


¹ Banka e Shqipërisë, mbështetur në rregulloren "Për transparencën dhe konfidencialitetin" publikon ndërhyrjet në tregun e parasë dhe atë valuator tre muaj pas përfundimit të periudhës.

26-02-04	5,220	1,869	
04-03-04	4,943	1,869	
11-03-04	6,507		
18-03-04	5,957		2,905
26-03-04	3,845		1,478

1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetës.

Në mbështetje të instrumenteve të tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 982 milionë lekë. Mungesa e likuiditetit në ditë të veçanta, solli dhe përdorimin e kredisë njëditore, mesatarisht 26 milionë lekë në ditë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2004.



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Tremujori i parë i vitit 2004 shënoi një periudhë të qetë përse i takon veprimeve të kryera nga Banka e Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor. Gjatë kësaj periudhe nuk është regjistruar asnjë veprim shitje-blerje në valutë me bankat e nivelit të dytë.